



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 146, Datë 24.06.2021

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT”  
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 13, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë ( ERE ), në mbledhjen e tij të datës 24.06.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 95/2 prot., datë 22.06.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi “Licencimin e shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 135, datë 07.06.2021, ka miratuar fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE me shkresën nr. 6/17 Prot., datë 08.06.2021, ka bërë publikimin në median e shkruar në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe në përfundim të afatit të njoftimit (datë 21.06.2021), nuk rezultuan vërejtje apo ankesa nga palët e interesuara.
- Shoqëria me shkresat nr. 714/1 prot., datë 09.06.2021 dhe nr. 714/2 prot., datë 16.06.2021, ka përcjellë në ERE të gjithë dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë rezulton se plotëson tërësisht kërkesat e *Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*, si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, **plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, **plotësuar;**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal., Neni 9, pika 3, gërma”a”, “b”,”c”, “d” **plotësuar;**
  - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjise elektrike, neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c”, **plotësuar.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikeqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**